

EPPC Albania kërkon një *Këshillues të lartë shitjesh (Agro)* në Vlorë për klientin e saj, një ndër institucionet financiare kredi-dhënëse më të suksesshme dhe të konsoliduara në vend prej më shumë se 2 dekadash.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Kryen të gjitha detyrat dhe ndërmerr të gjitha përgjegjësitë e Drejtorit të Degës gjatë mungesës së tij/saj sipas procedurës në fuqi për zëvendësimin e Drejtorit të Degës;
- Trajnon oficerët e rinj të kredisë duke bërë të mundur integrimin më të shpejtë të tyre në institucion;
- Suporton drejtorin e degës/agjencisë në gjithë procedurat operacionale;
- Analizon tregjet potencialë në mënyrë që të identifikojë nevojat të mundshme dhe zhvillon një plan kërkimor duke konsideruar profilin e duhur të klientit në institucion;
- Identifikon klientë potencialë (individë & biznese) dhe kryen takime me ta me qëllim informimin rreth produkteve dhe kushteve të kredisë;
- Vlerëson risqet lidhur me aplikimin për kredi agro duke konsideruar karakterin e klientit, stabilitetin e biznesit, aspektet sezonale dhe tregun, si dhe informacionin në sektorin përkatës;
- Zhvillon plane specifike për përsëritjen e biznesit me klientët ekzistues dhe ndërmerr nisma pasuese të duhura;
- Vlerëson rrisqet lidhur me aplikimet për kredi duke konsideruar një seri faktorësh dhe informacioni sipas kategorive dhe sektoreve përkatëse.
- Kryen analizën financiare saktësisht dhe referon vendimin e tij në komitetin e kredisë në përputhje me procedurat e kredidhënies;
- Qëndron i përditësuar në lidhje me produktet procedurat dhe politikat e reja, dhe termat dhe kushtet e reja të propozuara nga Kompania;
- Performon mbledhjen e hershme dhe intensive të kredisë dhe ndjek vonesat sipas strategjisë së kompanisë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- **Diplomë universitare** e preferueshme në Kontabilitet, Financë, Ekonomi, Administrim Biznesi ose në fusha të tjera të ngjashme;
- **Eksperiencia e Punës:** E preferueshme 3 vjet në një pozicion shitje në një institucion financiar;
- **Njohuri agro dhe njohje të zonave rurale;**
- Aftësi të mira negociuese, prezantuese, bindëse;
- Leje drejtimi automjeti.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.